
Energjia nga Burimet e Ripërtrishme në Shkallë të Vogël dhe Transformimi i Politikave si Domosdoshmëri

ANALIZË E POLITIKAVE

/2019



Energjia nga Burimet e Ripërtrishme në Shkallë të Vogël dhe Transformimi i Politikave si Domosdoshmëri

Autor: **Dardan Abazi**

Burim Ejupi

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Qershor, 2019**

Foto e ballinës: **PEXELS**

ISPN: **F3824284234**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondacionit të Vëllezërve Rockfeller. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

Hyrje	4
Sistemet e decentralizuara të energjisë	5
Mikrogeneratorët.....	8
Baza ligjore	8
Situata në terren dhe potenciali	10
Potencialet dhe opsionet.....	10
Intensitet i dyfishtë në përdorimin e energjisë	10
Analizë krahasimore e politikave	13
Përfundime.....	18
Rekomandime.....	19

Hyrje

Përpjekjet e Kosovës për të siguruar pavarësinë dhe qëndrueshmërinë e energjisë kanë qenë të ndryshme, të shtrenjta dhe vetëm gjysëm efektive, varësisht nga sektori i energjisë që kemi parasysh. Sfidat e sigurimit të pavarësisë së energjisë elektrike është në fokus të shumicës së diskutimit energjetik në vend. Me një termocentral të vjetër dhe një tjetër funksional, por që ka nevojë për renovim, përpjekjet e Kosovës për të qartësuar të ardhmen e saj të energjisë po hyjnë në dekadën e tretë. Sidoqoftë, zgjidhjet dhe përpjekjet e propozuara kanë qenë sipërfaqësore, në kundërshtim me zhvillimet e kohës dhe planifikimi ka qenë tejet i pakët. Para së gjithash, vendi ka përqëndruar përpjekjet e tij gjatë dekadës së fundit në ndërtimin e një termocentrali të ri të thëngjillit që ka marrë mbështetje të kufizuar ndërkombëtare dhe një interes të kufizuar nga investitorët potencialë. Megjithatë, përderisa përpjekjet për ndërtimin e një termocentrali të ri rrezikojnë një kosto të madhe, zhvillimi i energjisë së ripërtrishme ka mbetur prapa, masat e efijencës së energjisë nuk janë fuqizuar për t'iu përgjigjur nevojave dhe potencialit dhe pak vëmendje i është kushtuar teknologjive të reja të zhvilluara me kalimin e kohës.

Ky përqendrim pothuajse tërësisht me mendje të vetme në zhvillimin e një termocentrali të ri si zgjidhje për sfidat energjetike të vendit reflektohet në tërë dokumentet strategjike dhe planifikimin e politikave të Kosovës. Kryesisht, të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me burimet alternative të energjisë dhe masat e kursimit të energjisë dukshëm nuk kanë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj ndryshimit të sjelljes midis grupeve më të mëdha të konsumatorëve. Për më tepër, këto dokumente vazhdimisht kanë dështuar të përfshijnë dhe përditësojnë vlerësimet e tyre në lidhje me teknologji dhe qasje të reja të provuara në treg, të cilat do të ishin me kosto efektive në Kosovë. Së fundmi, të gjitha planifikimet strategjike kanë dështuar të kuptojnë dhe të synojnë nxitjen e infrastrukturës ekonomike mbështetëse për të mbështetur teknologjinë, mirëmbajtjen dhe, idealisht, kërkimin, inovacionin dhe zhvillimin e teknologjisë.

Kuadri ligjor në fushën e energjisë së ripërtrishme është i fokusuar për të përmbushur caqet e përcaktuara nga obligimi që rrjedhë nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, por jo shumë në potencialet dhe nevojat vendore. Kuadri aktual ligjor dhe politik i përqëndruar në kapacitetet e energjisë së ripërtrishme në shkallë të vogël është gjithashtu në fillimet e saj. Kuadri ligjor është vendosur vetëm nga viti 2018 për të siguruar opsionet për të futur dhe marrë nga rrjeti, për mikrogeneratorët ose konsumatorët me vetkonsum. Sidoqoftë, kuadri ligjor është i kufizuar dhe rruga e investimit për t'u futur në rrjet është e shtrenjtë dhe mungon një trajtim i duhur nga ana e kompanive në treg, veçanërisht kompania e distribucionit dhe furnizimit. Së fundi, shpërblimi apo incentiva shpesh nuk është tërheqës sa duhet dhe mjaftueshëm, ku prodhuesit potencial në shkallë të vogël u ofrohen vetëm kompensime për faturat e tyre të energjisë, në vend të mundësive për të realizuar disa të ardhura.

Më e rëndësishmja, masat e drejtpërdrejta në ndryshimet e sjelljes në lidhje me konsumin dhe kursimin e energjisë, si dhe zhvillimin e kapaciteteve gjeneruese në shkallë të vogël në treg kanë ngecur ndjeshëm. Megjithatë, kontrolli i kërkesës për energji elektrike dhe kapaciteti i vetë-qëndrueshëm i prodhimit mbeten dy masat më efektive të politikave në dispozicion të Kosovës dhe ato më të rëndësishme.

Së fundi, veprimet e dukshme të shterimit nga institucionet e Qeverisë së Kosovës (QK) janë gjithashtu të kufizuara. Instalimi i projekteve të ndriçimit publik të energjisë është i kufizuar. Instalimi i rrjeteve të zgjuara nëpër institucionet publike, sidomos ato që ballafaqohen me klientët, ka qenë e kufizuar. Instalimi i kapaciteteve gjeneruese në shkallë të vogël për ndërtesat publike nuk ekziston.

Fokusi miopik në zgjidhjen e problemeve të menjëhershme të rrjetit si dhe në zhvillimin e kapaciteteve gjeneruese të gjenerimit të centralizuar, ka ardhur në kurriz të zgjidhjeve të qëndrueshme afatgjata. Rruga e Kosovës drejt pavarësisë së energjisë duhet të përfshijë sisteme të lira, të përballueshme dhe të decentralizuara, si një hap drejt kalimit në burime të pastra dhe të ripërtëritshme të energjisë.

Sistemet e decentralizuara të energjisë

Sistemet e decentralizuara të energjisë janë modele moderne të funksionimit të sistemeve energjetike. Ato paraqesin një etapë të re të reformimit të sistemeve energjetike nga sisteme të centralizuara ku përgjegjësitë e prodhimit, tregut dhe furnizimit ishin të koncentruara në qendër, në sisteme ku prodhimi është i shpërndarë në njësi më të vogla. Këto njësi gjeneruese operojnë qoftë për konsum lokal qoftë si sisteme të vogla të cilat lidhen në rrjet dhe krijojnë mundësinë e shkëmbimit të energjisë dhe krijimit të mikrorrjetave të shërndarjes dhe tregtimit të energjisë.




Figura 1. Një sistem decentralizuar i energjisë. Burimi: PV Magazine marrë nga Sandro Bösch/ETH Zürich

Sistemet e decentralizuara të energjisë implementojnë disa nga vlerat më themelore të sistemeve energjetike të qëndrueshme:

- Rrisin efikasitetin e energjisë
- Rrisin përdorimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe ulin përdorimin nga burimet fosile¹

¹Chodokowska-Miszczuk, (2014), Small-Scale Renewable Energy Systems in the Development of Distributed Generation in Poland, Moravian Geographical Reports.





Figura2. Miksiaktualisistemitenergetik. Burimi: Balkan Energy Prospect

	Kapacitetet			Data e operacionalizimit	
	Instaluar	Neto	Min/max		
A1	65	Nuk operon			1962
A2	125	Nuk operon			1964
A3	200	144	100-130		1970
A4	200	144	100-130		1974
A5	210	144	100-135		1975
TC Kosova A	800	432			
B1	339	264	180-260		1983
B2	339	264	180-260		1984
TC Kosova B	678	528			
HC Ujmani	35	32			1983

HC Lumbardhi	8.08	8		-1957	2006
HC Dikanci	4.02	3.34		-1957	2013
HC Radavci	1	0.9		-1934	2010
HC Burimi	0.95	0.85		-1948	2011
Total HC	49.05	45.09			
EGU Belaja	8.06	7.5			2016
EGU Deçani	9.81	9.5			2016
HC Hydroline-Albaniku III	4.27	4.27			2016
HC Brod II	4.8	4.8			2015
Wind Power	1.35	1.35			2010
LedLight	0.1	0.1			2015
Centralifotovo Itaik ONIX	0.5	0.5			2016
Restelica 1&2	2.28	2.28			2016
HC Brezovica	2.1	2.1			2017
Total BRE	33.27	32.4			
Total	1,560.32	1,037.50			

Zhvillimi i sektorit ka qenë i ngadalshëm me një numër të limituar të autorizimeve finale të lëshuara për ndërtim. Siç shihet nga grafiku i mëposhtëm, një numër shumë i limituar i autorizimeve finale është dhënë dhe ato kanë qenë të koncentruara kryesisht në vitet e fundit.



Mikrogjeneratorët

Baza ligjore

Me Ligjin për Energjinë Nr. 05/L-081 janë përcaktuar politikat që kanë të bëjnë me BRE-të, që kanë për qëllim promovimin e shfrytëzimit ekonomik e të qëndrueshëm të potencialeve vendore të BREve, në funksion të plotësimit të nevojave për energji, rritjes së sigurisë së furnizimit dhe mbrojtjes së mjedisit e cila është pjesë përbërëse e Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës.

Për zbatimin e politikave të BRE-ve, Ministria përkatëse sipas legjislacionit në fuqi ka përcaktuar me akt të veçantë nënligjor caqet e energjisë nga BRE në harmoni me kërkesat e direktivës përkatëse të Bashkimit Evropian për BRE.

Me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-84 është përcaktuar se ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese (BRE), sistemeve të reja për bartjen dhe shpërndarjen e gazit natyror, përfshirë interkonektorët, si dhe linjat direkte elektrike dhe gazsjellësit direkt për bartjen e gazit natyror do të bëhet në pajtim me procedurën e autorizimit sipas këtij ligji, e cila do të ndërmerret nga Zyra e Rregullatorit për Energji, në përputhje me kritere objektive, transparente dhe jo-diskriminuese². Për të përmbushur obligimet ligjore për të arritur cakun e detyrueshëm për BRE deri në vitin 2020, Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013 dhe nr. 05/2017 me të cilin ka përcaktuar caqet vjetore dhe afatgjate të Energjisë nga BRE.

² Zyra e Rregullatorit për Energji, (2019), Raporti Vjetor për Vitin 2019, Prishtinë: ZRRE.

Udhëzimi Administrativ ka përcaktuar se, caku i detyrueshëm nga Burimet e Ripërtitshme të Energjisë deri në 2020, është 25 %³ të konsumit përfundimtar bruto të energjisë siç është përcaktuar në nenin 4 të Vendimit të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë Nr. D/2012/04/MC –EnC.

Shtojca I e këtij Udhëzimi Administrativ 05/2017 ka përcaktuar kapacitetet e Energjisë Elektrike nga BRE (MW), ku niveli i caqeve të përcaktuara për Burimet e Ripërtitshme të Energjisë dhe të pranuar në Skemën Mbështetëse është si në tabelën në vijim:

Kapaciteti i energjisë elektrike nga BRE					
Burimi primar i energjisë	2016	2017	2018	2019	2020
Fotovoltaike	6	7	8	9	30
Erë	1	61	115	129	150
HC të vogla	40	57	181	187	240
Biomasë	6	8	10	12	20

Baza kryesore ligjore për mbështetje të konsumatorëve me vet-konsum ose mikrogjeneratorëve është Rregulla Nr.10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtitshme.

Konsumatorit e energjisë elektrike që ndërtojnë gjenerator për vet-konsum të BRE-ve, mund të zgjedhin të mbajnë statusin e konsumatorëve prodhues, përmes një Skeme mbështetëse për Vetë-konsum. Skema mbështetëse për Vetë-konsum parasheh që:

- Furnizuesit marrin gjithë energjinë elektrike të prodhuar dhe e dërgojnë gjithë energjinë elektrike të konsumuar nga konsumatorët prodhues, brenda një periudhe të faturimit;
- Furnizuesit llogarisin Bilancin e konsumatorëve prodhues të periudhës së faturimit, sipas të cilit përgatitet fatura mujore;
- Nëse bilanci i konsumatorëve prodhues është pozitiv atëherë konsumatori prodhues, kreditohet në energji (kWh) në periudhën e ardhshme faturuese;
- çdo bilanc pozitiv i papaguar në periudhën e fundit të faturimit të vitit kalendarik rifillon nga zero pa kompensim nga Furnizuesi;
- Nëse Bilanci i konsumatorëve prodhues është negativ, atëherë Furnizuesi faturon konsumatorin prodhues për vlerën e Bilancit vetë-prodhues⁴

Sipas kësaj Rregulloreje, furnizuesit detyrohen në hyjnë në Marrëveshje për vetë-prodhim me çdo konsumator prodhues me të cilin kanë kontratë për furnizim me energji elektrike sipas termeve dhe kushteve të specifikuar në Rregullore. Marrëveshja për vetë-prodhim, mes tjerash, duhet të përcaktoj obligimin e furnizuesit për marrjen e të gjithë prodhimit të energjisë elektrike të gjeneruar nga konsumatori prodhues.

çdo konsumator i energjisë elektrike i kyçur në tensionin e ulët të rrjetit të shpërndarjes mund të aplikoj tek furnizuesi i tij për marrjen e statusit të konsumatorit prodhues, në përputhje me nenin 27 të Rregullës së Procedurës së Autorizimit dhe në përputhje me formularin e aplikimit në

³ Qeveria e Kosovës, (2017), Udhëzimi Administrativ 05/2017, Prishtinë: Regjistri i Akteve Nënligjore.

⁴ Zyra e Rregullatorit për Energji, (2017), Rregulla Nr.10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtitshme, Kreu V, Prishtinë: ZRRE.

Shtojcën 3 dhe të njëjtin aplikacion duhet ta dorëzoj në Rregllator. Furnizuesi e informon Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, brenda (10) ditësh pune të pranimit të aplikacionit të referuar në paragrafin 1 të nenit 20 të rregullës. Brenda 10 ditësh pune pas pranimit të njoftimit, OSSH lëshon kushtet e kyçjes, përfshirë kërkesat e nevojshme për kyçe me të cilat konsumatori prodhues duhet të pajtohet në mënyrë që të implementoj këtë Rregull. Me rastin e konfirmimit të pranimit teknik të kyçjes, furnizuesi i dorëzon konsumatorit prodhues një koje të Marrëveshjes, e cila nënshkruhet jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas dorëzimit të saj.⁵

Situata në terren dhe potenciali

Implementimi i Rregullës Nr.10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripëtrrsishme ka hasur në vështirësi sidomos në numrin e konsumatorëve me vetkonsum të licencuar.

Nr.	Subjekti Juridik	Objekti	Lokacioni	Kapaciteti i instaluar	Data e Lëshimit të Vendimit
1	N.T. LIRIDONI	Solare	Llapnasellë, Graçanica	95 kW	24 shtator 2018
2	Agro Trade SH.P.K.	Solare	Llapnasellë, Graçanica	55.2 kW	24 shtator 2018
3	Çarshia SH.P.K.	Solare	Lagjja Marigona, Graçanica	100 kW	24 shtator 2018

Potencialet dhe opsionet

Intensiteti i dyfishtë në përdorimin e energjisë

Energjia nga burimet e ripërtrishme duhet të shoqërohet me masa të eficiencës së energjisë. Intensiteti i Energjisë në Kosovë është në nivel shumë të lartë. Intensiteti i energjisë është definuar si vlera e njësisë së energjisë së shpenzuar për çdo njësi të Bruto Produktit Vendor (GDP-së). Pra, intensiteti energjetik synon të masë se sa shpenzohet energji për t'u krijuar një njësi e GDP-së.

Energjia shprehet në kiloton ekuivalent si njësi unifikuese e njësive të energjisë (energjisë elektrike, naftës, gazit natyror etj.). Tabela në vazhdim shpjegon nivelin e intensitetit energjetik në Kosovë.

⁵ Ibid, neni 20.

Table 9: Main parameters for developing the energy demand forecast for the services sector			
Year	GDP-Service [Million EURO]	Energy intensity for the services sector [ktoe/Million EURO]	Population
2003	430.44	0.319896	1954000
2004	443.03	0.294902	1977448
2005	462.80	0.315717	2001177
2006	495.20	0.322031	2025192
2007	529.86	0.328472	2049494
2008	566.95	0.335041	2074088
2009	606.64	0.341742	2098977
2010	649.11	0.348577	2124165
2011	688.05	0.355549	2141158
2012	729.34	0.362660	2158287
2013	773.10	0.369913	2175553
2014	819.48	0.377311	2192958
2015	868.65	0.384857	2210501
2016	921.63	0.392554	2228184
2017	956.90	0.400406	2246011
2018	996.45	0.408414	2263979

Figura 3. Niveli i Intensitetit të Energjisë në Kosovë. Burimi: Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës

Trendi është i qartë në rritje. Nëse shohim nivelin e intensitetit energjetik në vendet e BE-së, diferenca është jashtëzakonisht e madhe. Trendi është krejtësisht në ulje në BE. Në mes të viteve 2005 dhe 2016 niveli i intensitetit energjetik në BE ra për 17.5% me një mesatare vjetore prej 1.7%.⁶Niveli i intensitetit energjetik në Kosovë është dyfish sa niveli i mesatares në Bashkimin Evropian. Megjithatë, kjo do të thotë se potenciali për intervenim është i lartë dhe politikat që duhen ndjekur janë të shumta.

Të gjetura tjera që ja vlen të theksohen janë në ligjet e Shqipërisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Rumanisë. Neni 10 i ligjit të Shqipërisë përcakton burimet financiare për realizimin e programit kombëtar të efijencës së energjisë dhe në Nenin 11 theksohen organi kompetent për administrimin e fondit për Efijencën e Energjisë.⁷ Me anë të Neneve 8, 10, 14 dhe 27 Mali i Zi demonstroi që e ka Ligjin më të kompletuar për Efijencën e Energjisë: Qeveritë lokale detyrohen të dorëzojnë një Program për Përmirësimin e Efijencës tek Ministria; theksohet që Planet Komunale duhen të jenë të ndërlidhura me Strategjinë/Planin kombëtar të për Efijencën (Neni 10); Komunitet detyrohen që të bëjnë fushata vetëdijesimi për efijencën (Neni 14); me rastin e shitjes së një objekti ose të lëshimit me qera, pronari duhet të ja dorëzojë blerësit një certifikatë të përfundimit të energjisë së atij objekti (Neni 27).⁸ Ligji i Bullgarisë Neni 5, në anën tjetër, i

⁶European Environment Agency, (2019), Intensity of final energy consumption, marrë nga EEA, www.eea.europa.eu/data-and-maps/indicators/final-energy-consumption-intensity-4/assessment-2

⁷Ligji Nr. 9379 për Efijencën e Energjisë, Republika e Shqipërisë, faqe 5

⁸Law on Energy Efficiency, Montenegro, faqe 4,5,6 dhe 11

obligon kompanitë që merren me ekstraktimin, përpunimin dhe shpërndarjen e energjisë që të bëjnë studime dhe analiza me parashikime për ekstraktimin dhe procedimin e burimeve të energjisë. Gjithashtu, një herë në dy vjet duhet të dërgojnë raporte tek Ministria për masat e përmirësimit të efijencës së energjisë.⁹ Ndërkohë ajo çka Ligji i Rumanisë përmban për dallim nga vendet e tjera është shpjegimi i principeve dhe objektivave të Strategjisë Kombëtare të Energjisë (Neni 3).¹⁰

⁹Law on Energy Republic of Bulgaria, faqe 3

¹⁰Law concerning the efficient use of energy, Romania, faqe 1

Analizë krahasimore e politikave

	<u>Kosova</u>	<u>Shqipëria</u>	<u>Mali i Zi</u>	<u>Serbia</u>	<u>Kroacia</u>	<u>Bullgaria</u>	<u>Rumania</u>	<u>Turqia</u>	<u>EU - Direktiva</u>
Rregullatori	Agjencia	Agjencia	Ministria	Agjencia	Keshilli i rregullatorit të energjisë	Komisioni i shteteror i rregullimit të energjisë	Agjencia	Bordi Koordinues për Eficiencë të Energjisë	Shtetet anëtare
Objektivi	9% deri në 2020	26% deri në 2020	9% deri në 2016	/	0.47 Mtoe deri në 2016	Pa specifikuar	2.8 Mtoe deri në 2016	20% deri në 2023	20% deri me 2020
Niveli Komunal	Zyrat komunale	Njësitet e qarqeve	Njësitet e veteqeverisjes lokale	Njësitet e veteqeverisjes lokale	Komunat	Njësitet e veteqeverisjes lokale	Njësitet lokale të Ministrise	Asociacioni i Komunave	
Spektori privat	√ (Në Plan të Veprimit)	√	√	√	√	√	√	√	√
Auditimi	Me akt nënligjor	Në ligj	Në ligj	Me akt nënligjor	Me akt nënligjor	Në ligj	Me akt nënligjor	Në ligj	Direktiva
Auditimi i sistemeve të ngrohjes dhe klimatizimit	X	X	√	X	X	X	X	X	√

Autoriteti që e bënë licencimin e auditoreve	Këshilli	Ministri	Ministria	/	/	Ministri	/	Ministria	
Subvencionet	X	X	√	X	X	X	√	√	/
Edukimi/Informimi	X	X	√	√	√	X	√	√	√
Gjobat - maksimalja	X	730 €	300 x paga minimale	25 000 €	X	75 000 €	330 000 €	22 600 €	√
Informatat në fature	X	X	√	X	X	X	X	X	√
Matësit inteligjent të rrymes	X	X	X	√	X	X	√	X	√

<p>Masat Stimuluese</p>	<p>√ Fondi</p>		<p>Kompanitë që janë eficiente në konsumin e energjisë mund të lirohen nga taksat (Neni 43). Shpërndarësi i energjisë duhet të ofroj cmime të favorshme për përdoruesit eficient të energjisë (Neni 46)</p>		<p>Sistemi I tarifave duhet të ofroj cmime të favorshme për eficiencën e energjisë dhe përdorimin e burimeve të ripërtirshme të energjisë. (Neni 26)</p>		<p>Ekziston një fond special për arritjen e objektivave të eficiencës së energjisë, ku konsumatorët e energjisë mund të përfitojnë financime për projekte lidhur me eficiencën (Neni 21)</p>	<p>Mbështetje financiare për projektet që e promovojnë përdorimin eficient të energjisë (Neni 8).</p>	
--------------------------------	---------------------------	--	---	--	--	--	--	---	--

Ne kemi bërë një studim krahasues të Ligjit për Eficiencën e Energjisë Elektrike të Kosovës me disa vende të rajonit. Ligjet e vendeve të përdorura në këtë studim janë: Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Kroacia, Bullgaria, Rumania dhe Turqia. Gjithashtu është konsultuar edhe direktiva e Bashkimit Evropian 2011/0172 për Eficiencën e Energjisë. Në këtë pjesë në i paraqesim të gjeturat kryesore të këtij studimi, që kryesisht kanë të bëjnë me mungesat e Ligjit të Eficiencës së Kosovës në krahasim me Ligjet e vendeve të lartpërmendura. Aneksi 1 mund të shërbejë si përmbledhje e informatave të paraqitura në këtë pjesë. Duhet të theksohet se Ligji për Eficiencën e Energjisë i Kosovës është i cekët në shumë fusha pasi që një mori masash janë të përcaktuara me Planin e Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2010-2018, e në anën tjetër shtetet e lartpërmendura listojnë më shumë masa në Ligjet e Eficiencës së Energjisë. Sidoqoftë, në i kemi kushtuar një rëndësi të madhe përmbajtjes së Planit të Veprimit në mënyrë që studimi të jetë sa më gjithëpërfshirës.

Agjencia për Eficiencën e Energjisë, si organ rregullator për Eficiencën e Energjisë, përveç Kosovës është e pranishme edhe në Shqipëri, Serbi dhe Rumania. Në Kroaci e kemi Këshillin e Rregullatorit të Energjisë, në Bullgari Komisionin Shtetëror të Rregullimit të Energjisë dhe në Turqi Bordin Koordinues për Eficiencë të Energjisë. Me direktivën 2011/0172 të Bashkimit Evropian parashihet që deri më 2020 të kursehet 20% e konsumit primar të energjisë. Kjo shifër qëndron në 18% deri më 2018 për Kosovën, 26% deri më 2020 për Shqipërinë, 20% deri më 2023 për Turqinë, 9% deri në 2016 për Malin e Zi, 0.47 Mtoe deri më 2016 për Kroacinë dhe 2.8 Mtoe deri në 2016 për Rumaninë.

Auditimi i sistemeve të ngrohjes është një tjetër mekanizëm i rëndësishëm për të kursyer energjinë. Kjo parashihet edhe në direktivën 2011/0172 të Bashkimit Evropian për Eficiencën e Energjisë. Ky mekanizëm është i përfshirë vetëm në Ligjin për Eficiencën e Energjisë së Malit të Zi dhe mungon në të gjitha vendet e tjera. Neni 24 i Ligjit për Eficiencën e Energjisë së Malit të Zi flet për auditimin e bojlerëve, kurse Neni 25 për auditimin e sistemeve të klimatizimeve.¹¹ Në Ligjin për Eficiencën e Energjisë së Kosovës, Neni 12 e parasheh miratimin e aktit nënligjor për auditimin e energjisë në përputhje me direktivat e BE-së, akt të cilin Qeveria ende nuk e ka miratuar.¹²

Në mënyrë që konsumuesit e fundit të energjisë të jenë të informuar në lidhje me rëndësinë e të të kursyerit të energjisë, masat vetëdijësuese duhet të jenë në shërbim të qytetarëve. Mali i Zi, Serbia, Kroacia, Rumania dhe Turqia e përmendin edukimin si një komponentë për promovimin e përdorimit eficient të energjisë, përderisa Kosova, Shqipëria dhe Bullgaria nuk e bëjnë këtë gjë. Ja vlen të theksohet rasti i Turqisë ku Neni i 6-të e obligon çdo televizion dhe radio që të transmetoj të paktën 30 minuta në muaj spote vetëdijësuese për eficiencën.¹³

Sanksionet për ata që nuk iu nënshtrohen rregullave të parapara me ligj janë mjaft evidente në Ligjet për Eficiencën e Energjisë në shtete të ndryshme. Nga ato të zgjedhura për këtë analizë, vetëm Kosova dhe Kroacia nuk gjoba, përderisa vendet tjera kanë. Gjobën maksimale më të lartë e ka Rumania me gjobat mund të shkojnë deri në 330,000€¹⁴ dhe më të ultën Shqipëria me 730€¹⁵.

¹¹Law on Energy Efficiency, Montenegro, faqe 10 dhe 11.

¹²Ligji Nr. 04/L-016 për Eficiencën e Energjisë i Kosovës, faqe 5.

¹³Energy Efficiency Law No. 5627, Turkey, faqe 5.

¹⁴Law concerning the efficient use of energy, Romania, faqe 7.

¹⁵Ligji Nr. 9379 për Eficiencën e Energjisë, Republika e Shqipërisë, faqe 6.

Direktiva 2011/0172 e Bashkimit Evropian thotë që fatura e pagesës së energjisë elektrike duhet të përmbajë informata rreth eficiencës. Kjo është e cekur vetëm në Ligjin për Eficiencën e Energjisë së Malit të Zi, dhe mungon në shtatë vendet e tjera duke e përfshirë edhe Kosovën. Një komponentë tjetër që hyn në direktivën e BE-së e që shumica e shteteve të rajonit nuk e plotësojnë janë matësit inteligjent të rrymës. Vetëm Serbia dhe Rumania kanë bërë progres në këtë fushë, mirëpo edhe Kosova ka përparime pasi që është një pilot projekt për instalimin e matësve inteligjent të rrymës (citim).

Në katër nga tetë shtetet e përdorura për këtë analizë hasim në detyrime për prodhuesit dhe importuesit e produkteve që konsumojnë energji. Në Kosovë, në pikën V.2.1 të Planit të Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2010-2018, kemi instruksione administrative për etiketimin e pajisjeve elektroshtëpiake.¹⁶ Në Shqipëri, në Nenin 5 detyrohet etiketimi (në gjuhën shqipe) i pajisjeve elektrike shtëpiake për prodhuesit dhe importuesit e tyre, ku në mes tjerash duhet të ketë informata rreth eficiencës së energjisë për produktin.¹⁷ Në Mal të Zi, Neni 36 parasheh që produktet futen në treg vetëm nëse i përmbushin kërkesat eko-eficiente të parapara nga Ministria, kurse Neni 38 thotë që në etiketimin e produktit duhet të vendoset informata rreth eficiencës së energjisë.¹⁸ Në Kroaci, Neni 13 obligon që të e përshkruajnë në etiketim llojin e energjisë apo lëndës djegëse dhe eficiencën e energjisë të atij produkti.¹⁹

‘Konsumuesit e Mëdhenj të Energjisë’ janë ato kompani të cilat e kalojnë një shifër të konsumit vjetor të energjisë të caktuar me rregullore, term që përdoret në Mal të Zi dhe Rumani. Neni 20 i Ligjit për Eficiencën e Energjisë i Malit të Zi i obligohen ‘Konsumuesit e Mëdhenj të Energjisë’ që të zhvillojnë plane vjetore për përmirësimin e eficiencës, si dhe raporte të zbatimit të tij.²⁰ Neni 41 i po të njëjtit ligj obligon ‘Konsumuesit e Mëdhenj të Energjisë’ që të krijojnë sisteme të informimit për monitorimin e konsumit të energjisë dhe Neni 42 thekson që duhet të shkruajnë raporte vjetore për disa specifika.²¹ Në anën tjetër, edhe Ligji i Rumanisë i përmban disa detyrime për ‘Konsumuesit e Mëdhenj të Energjisë’, specifikisht Neni 5 ku thuhet që këto të fundit duhet të krijojnë programet e tyre të eficiencës së energjisë afat shkurte dhe afatgjate.²²

Një tjetër komponentë e promovimit të përdorimit eficient të energjisë janë masat stimuluese, që mund të jenë në formë të subvencioneve apo formave tjera. Analiza tregon që katër nga tetë shtete kanë masa stimuluese: Mali i Zi, Kroacia, Rumania dhe Turqia. Njëra nga masat më të shpeshta të përdorura është lirimi nga taksat që mund të vërehet në Nenin 43 të Malit të Zi²³ dhe Nenin 22 të Rumanisë²⁴. Ofrimi i çmimeve të favorshme nga shpërndarësi i energjisë për përdoruesit eficient thuhet në Nenin 46 të Malit të Zi²⁵ dhe Nenin 26 të Kroacisë²⁶. Në Rumani Neni 21 e parasheh krijimin e një fondi special për arritjen e objektivave të eficiencës së energjisë, ku konsumatorët e energjisë mund të përfitojnë financime për projekte lidhur me eficiencën. Për më tepër, Neni 22 i

¹⁶Kosovo Energy Efficiency Action Plan 2010-2018, First Kosovo Midterm Energy Efficiency Action Plan (2010-2012), faqe 29.

¹⁷Ligji Nr. 9379 për Eficiencën e Energjisë, Republika e Shqipërisë, faqe 2.

¹⁸Law on Energy Efficiency, Montenegro, faqe 14.

¹⁹Energy Act, Republic of Croatia, faqe 5

²⁰Law on Energy Efficiency, Montenegro, faqe 20

²¹IBID, faqe 15

²²Law concerning the efficient use of energy, Romania, faqe 2

²³Law on Energy Efficiency, Montenegro, faqe 15

²⁴Law concerning the efficient use of energy, Romania, faqe 6

²⁵Law on Energy Efficiency, Montenegro, faqe 16

²⁶Energy Act, Republic of Croatia, faqe 9

të njëjtit vend i stimulon kompanitë efiçientë duke ju ofruar kredi me interes të favorshëm dhe lirim nga taksa në profit dhe taksa doganore.²⁷ Turqia, në anën tjetër, jep mbështetje financiare për projektet që e promovojnë përdorimin efiçient të energjisë (Neni 8) dhe ofron: trajnime, konsultime dhe auditime falas për firmat e vogla dhe të mesme, si dhe certifikatat e autorizimit dhe ato për menaxher të energjisë jepen falas (Neni 9).²⁸ Plani i Veprimi 2010-2018 i Kosovës, pika V.2.10, thekson që 10 milion euro janë të gatshme për të u shpërndarë si kredi për individë dhe biznese të vogla e të mesme për të financuar projekte që kanë të bëjnë me efiçencën e energjisë.²⁹

Detyrimet për objektet që shpenzojnë energji kemi në Malin e Zi, përkatësisht në Nenin 21 ku çdo ndërtesë e re apo që i nënshtrohet një renovimi të madh duhet të jetë e dizajnuar që të shpenzon sasi të caktuar të energjisë.³⁰ Gjithashtu edhe në Turqi Neni 7 thotë çdo ndërtesë që ka mbi 20,000 m² apo konsum me mbi 500 TOEs duhet të ketë një menaxher të energjisë, ndërsa kompanitë private me mbi 5000 TOEs konsum vjetor duhet të kenë një njësit të energjisë.³¹ Për fat të mirë, edhe Kosova në Planin e Veprimit pikën V.2.8 liston masa për rregullat teknike për performancën e energjisë së ndërtesave.³²

Për dallim nga detyrat e Agjencisë së Kosovës për Efiçencën e Energjisë që përshkruhen në Nenin 6 të Ligjit për Efiçencën e Energjisë së Kosovës: Agjencia për Efiçencën e Energjisë e Serbisë mund të propozoj masa nxitëse për përdorimin efiçient të energjisë (Neni 147)³³; Agjencia e Rumanisë merret me akreditimin e institucioneve që merren me teste dhe matje si dhe e ka kompetencën që të krijojë standarde për matjet (Neni 13)³⁴; Në Turqi, Bordi Koordinues për Efiçencë të Energjisë, që është rregullatori i efiçencës së energjisë në këtë vend: bën studime për efiçencën, i monitoron rezultatet dhe zbaton ato, bën certifikime, aprovon projekte të sektorit privat, dhe organizon takime të komiteteve këshilluese (Neni 4).³⁵

Përfundime

Sistemet e gjenerimit të distribuuar ose të decentralizuar luajnë një rol të jashtëzakonshëm në transformimin e sistemeve energjetike. Energjia nga burimet e ripërtrishme në shkallë të vogël është kryesore për sigrimin e dekarbonizimit të sistemeve energjetike.

Qeveria e Kosovës dhe shoqëria në përgjithësi përballen me mungesë të theksuar të statistikave në fushën e burimeve të ripërtrishme, sjelljeve konsumatore dhe efiçencës së energjisë. Në këtë mënyrë është e pamundshme që politikëbërja të bazohet në të dhëna dhe të kemi vendimmarrje më të mirë.

Ndonëse ekziston rregullativa në vend, ende periudha e kohëzgjatjes së marrjes së autorizimit final po zgjatë shumë me një mesatare prej mbi 500 ditësh nga marrja e autorizimit preliminar në atë përfundimtar. Legjislacioni dhe rregullativa për një One Stop Shop ende mungon dhe ai që është

²⁷Law concerning the efficient use of energy, Romania, faqe 6

²⁸Energy Efficiency Law No. 5627, Turkey, faqe 8 dhe 9.

²⁹Kosovo Energy Efficiency Action Plan 2010-2018, First Kosovo Midterm Energy Efficiency Action Plan (2010-2012), faqe 8

³⁰Law on Energy Efficiency, Montenegro, faqe 9

³¹Energy Efficiency Law No. 5627, Turkey, faqe 6

³²Kosovo Energy Efficiency Action Plan 2010-2018, First Kosovo Midterm Energy Efficiency Action Plan (2010-2012), faqe 36

³³Energy Law, Republic of Serbia, faqe 52

³⁴Law concerning the efficient use of energy, Romania, faqe 4

³⁵Energy Efficiency Law No. 5627, Turkey, faqe 3

projektuar është thjeshtë një zyrë informimi dhe jo një One Stop Shop në kuptimin e mirëfillt të fjalës.

Rregulla për Mbështetjen e Gjeneratorëve me Prodhim nga Burimet e Ripërtrishme është e miratuar por implementimi i saj mungon. Skema është me limit të prodhimit dhe me limit të periudhës së kompensimit. Gjithashtu, balancet pozitive nuk kompensohen dhe gjeneratorët me vetkonsum kompensohen vetëm me kthim të energjisë. Sidoqoftë, edhe kjo skemë që është në fuqi ende nuk ka gjetur zbatueshmërinë e duhur. Vetëm 3 aplikacione janë aprovuar gjatë vitit 2018 dhe si të tilla janë aprovuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

Zhvillimi i burimeve të ripërtrishme në shkallë të vogël kufizohet ndjeshëm edhe nga mungesa e vetëdijes dhe politikave që do të bashkërendonin politikat e eficiencës së energjisë me burimet e ripërtrishme. Një kornizë e përbashkët e politikave nuk ekziston në këtë fushë dhe është e domosdoshme që të arrihet.

Rekomandime

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile, donator dhe Agjencinë e Eficiencës së Energjisë duhet:

1. Të iniciojë një studim të detajuar mbi praktikat e konsumit dhe trendet e konsumit të konsumatorëve familjarë, NMV-ve dhe organizatave të mëdha biznesore. Ky studim duhet të fokusohet në njohjen e nevojave të konsumit, niveleve aktuale dhe eficiencës së energjisë në shtëpi/pajisje të biznesit, sjelljeve karshi eficiencës dhe sfidave për implementimin e masave të eficiencës nga aspekti i të hyrave dhe madhësisë së bizneseve. Rezultatet e këtij studimi duhet të jenë pulike dhe të inkurajojnë vendimmarrësit dhe bizneset në procesin e politikëbërjes.
2. Inicioj një studim mbi politikat që nxisin kapacitetet në shkallë të vogël të gjenerimit nga burime të ripërtrishme për energjinë elektrike ose ngrohjen. Studimi duhet të fokusohet në vlerësimin e katër komponentëve kryesorë:
 - a. Të kuptuarit e barrierave ndaj kërkesave në rritje për kapacitete të reja me shkallë të vogël gjenerimi;
 - b. Të kuptuarit e barrierave që kanë bizneset që aktualisht operojnë, ose synojnë të operojnë me instalime dhe mirëmbajtje të sistemeve me shkallë të vogël gjenerimi të rrymës dhe ngrohjes.
 - c. Kuantifikimi i të dhënave për kostot e tanishme të konsumatorëve për energjinë e prodhuar nga gjeneratorë me shkallë të vogël dhe përcaktimi i kornizave të një plani për ulje të kostove deri në nivele të tregut.
 - d. Vlerësimi i përpjekjeve të suksesshme në ekonomitë e krahasueshme të fokusuara në zhvillimin dhe adoptimin e sistemeve gjeneruese në shkallë të vogël dhe transpozimin e mësimave të nxjerra në Kosovë.

3. Përditësimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë për të përfshirë objektivat dhe synimet për të përfshirë:
 - a. Dispozitat specifike që kërkojnë përshtatjen e rrjetit të shpërndarjes për ta bërë atë të lehtë dhe të përballueshëm për zonat me mundësi të mëdha për të zbatuar kapacitete të vogla gjeneruese për t'u futur në rrjet;
 - b. Dispozita të veçanta që do t'u kërkonin rregullatorëve dhe operatorëve të tregut të zvogëlonin barrierat rregullatore për njësitë e gjenerimit individual me shkallë të vogël në mënyrë që ato të kyçen në rrjet dhe të operojnë.
 - c. Fillimi i krijimit të skemave për financim të përballueshëm dhe / ose dhënia granteve dhe instrumenteve financuese për adoptuesit e mundshëm të sistemeve me shkallë të vogël gjenerimi.

4. Të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, në atë mënyrë që:
 - a. Të siguroj funksionalitetin e Bordit të ZRRE-së duke inicuar procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të bordit së paku 6 muaj para skadimit të mandatit për të evituar rastet kur investitorët presin për licenca në mungesë të Bordit.
 - b. Të garantoj pavarësi në vendimmarrje dhe në financa të ZRRE-së dhe të siguroj se principet e